



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 96-të të mbajtur më 27.11.2023, ka miratuar sa vijon,

VENDIM

Denoncimi me numër 12-5360/1 nga 21.11.2023, *HIDHET POSHT*.

Denoncimi nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-5360 nga 2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Lënda me numër 12-5360/1 datë 21.11.2023 është formuar në bazë të denoncimit së paraqitur nga një parashtrues i panjohur. Në denoncim është shprehur pakënaqësi për mënyrën e organizimit të punës në Komunën /// dhe shkollat komunale dhe punësimin në institucionet komunale. KSHPK-së i kërkohet shqyrtimi i çështjes në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Nuk u paraqit asnjë provë në mbështetje të denoncimit.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së denoncimit, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent. Pretendimet në denoncim janë të përgjithshme, pa përmendur konkretisht zyrtarët dhe pretendimet që do të rezultonin me elemente për veprim kompetent nga KSHPK-ja.

Duke qenë se denoncimi është dorëzuar nga një denoncues i panjohur, dhe nuk ka mundësi për të dhënë të dhëna dhe informacione shtesë për rastin në fjalë, KSHPK-ja vendosi të refuzojë kërkesën dhe të mbyllë dhe arkivojë lëndën.

Për sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dërguar:

- Arkivi i KSHPK-së

përgatiti: Mr. D.D

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОР
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
Kryetar,
Biljana Ivanovska

